



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.05.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.05.2026, të parashtruar nga " BONN PROJEKT " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve të ndërtimit të lartë", Nr. i prokurimit- 632-26-2388-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-007-221, nxjerr:

### V E N D I M

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " BONN PROJEKT " SH.P.K., e dt.08.05.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Hartimi i projekteve të ndërtimit të lartë", Nr. i prokurimit- 632-26-2388-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-007-221, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 29.04.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Përmirësohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 29.04.2026;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " BONN PROJEKT " SH.P.K., me dt.08.05.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve të ndërtimit të lartë", Nr. i prokurimit- 632-26-2388-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-007-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 14.05.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

#### Pretendimi 1:

1. Certifikatë për organizim dhe menaxhim te kantierit te ndërtimit / Kjo është kërkuar pasi kemi parapa edhe ne paramase qe OE do te beje edhe hartim te projektit për organizim te punishtes. ne si

Autoritet kontraktues po kemi shume probleme gjate ekzekutimit për shkak te organizimit te punishtes e kostove shtese. Kështu e konsiderojmë qe është e nevojshme një certifikatë e tillë.

2. **Arkitekti i licencuar nga MKRS** është e domosdoshme për pajisje me leje/pëlqim nga IKMM për objekte te trashëgimisë kulturore, pasi qe pa Arkitekt te licencuar dhe licence B1 te kompanisë IKMM nuk e mer parasysh fare dosjen/projektin qe e dorëzojmë ne si komune. Kështu këto licenca janë te nevojshme dhe te domosdoshme për monumente te trashëgimisë kulturore. Ne si Autoritet kontraktues vazhdimisht kemi projekte te tilla e qe kane nevojë për licenca te tilla.
3. **Një inxhinier i certifikuar për AutoCAD.** Konstatojmë qe është e nevojshme te jete se paku një i tillë për një Kompani projektuese, qe te jete i specializim/certifikim për përdorim te softuerëve gjate hartimit te projekteve për nevoja te AK.
4. **Një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Mbrojtje të Mjedisit, si dhe të jetë i certifikuar me VSM (Hartimin e Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planet Hapësinore)** – Kjo kërkesë mundet që të mos jetë e domosdoshme ne këtë Aktivitet, andaj do të largohet si kërkesë.

#### Pretendimi 2:

1. Sa i përket pajisjeve qe kryesisht janë gjeodezike dhe për përpunimin e tyre.  
Ne si Autoritet kontraktues konsiderojmë qe pajisjet e tilla janë te nevojshme për matje precize dhe te sakta dhe për te bere matje ne terrene te ndryshme (ambiente te brendshme, te jashtme, terrene te papërshtatshme, terrene te pa çastshmen etj). Andaj, konstatojmë qe pajisjet e tilla apo te ngjashme me performance siç janë kërkuar apo me te avancuara (me te mira) janë te pranueshme nga Autoriteti kontraktues.

Janë kërkuar ka dy cope psh 2 GPS; 2 Total Station; 2 Dron; 2 Lidar; 2 PC; 2 Llaptop.

Sa i përket PC dhe llapëtoreve, janë kërkuar me performance për te proceduar te dhënat nga këto pajisje gjeodezike, sepse jo çdo pc apo llaptop mund ti procesoj ato.

Për te zvogëluar kriteret ne mund te kalojmë nga 2 pajisje për secilën ne 1 pajisje për secilën (dmth sasi minimale), kështu që Autoriteti kontraktues do të largoj pikat 1, 3, 5, 7, 9 dhe 12 nga lista e pajisjeve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

